



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2021:145330  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05441937

**C.nr. 1023/21**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin individual Fuad Haliti, në çështjen juridike të paditësve 1.H.SH, 2. Z.T, 3.H.P, 4.F.S dhe 5.T.I nga Mitrovica, të cilët sipas autorizimit i përfaqson av.Isa Hyseni, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, baza juridike, kompensim e pagave shtesë ne emër të licencimit, më datë 12.03.2024, jashtë seancës gjyqësore nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE** me numër C.nr.1023/21 e datës 22.01.2024 (Nd:479/2023) e arritur në procedurën e ndërmjetësimit, në mes të paditësve H.SH, Z.T, H.P, F.S dhe T.I kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

**Arsyetim**

Paditësit me datën 06.07.2021 pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padinë për kompensimin e pagave shtesë ne emër të licencimit

Me datën 22.01.2024, gjykata është njoftuar se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit pranë ndërmjetësuesit Mentor Boja i cili këtë marrëveshje me shkrim i'a ka dorëzuar gjykatës.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të cilat gjinden në lëndë konsiderojë se janë plotësuar kushtet për aprovimin e kësaj marrëveshje të arritur në procedurën e ndërmjetësimit dhe vendosi si në Sipas nenit 15 paragrafi 4 i Ligjit për Ndërmjetësimin *“Nëse Ndërmjetësimi fillon me vetëinicimin e palëve, marrëveshja e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe*

*ndërmjetësuesi, e cila përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes, ka fuqinë e dokumentit përmbarues në përputhje me ligjin përkatës për procedurën përmbarimore.”*

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**

**C.nr.1023/21, me datë 12.03.2024**

**Gjyqtari**

**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta në ankesë.